


Treguesit demografikë

Tremujori 3, 2017

Tiranë, më 26 Dhjetor 2017: Numri i lindjeve për tremujorin e tretë 2017, rezulton 7.203, duke shënuar një rënie me 20,7 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Numri i vdekjeve për tremujorin e tretë 2017 rezulton 4.853, duke shënuar një rritje prej 3,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016.

Gjatë tremujorit të tretë 2017, numri i lindjeve tejkaloi me 2.350 numrin e vdekjeve. Shtesa natyrore e popullsisë, për tremujorin e tretë 2017, pasqyron një rënie me 46,7 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016.

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë




Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e tretë 2017, për 12 qarqet e Shqipërisë, regjistron vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.068 numrin e vdekjeve. Me shtesë natyrore të lartë paraqitet qarku i Durrësit, me 374 lindje më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Elbasanit me 321 lindje më shumë se vdekje.

Në tremujorin e tretë 2017, shtesa natyrore regjistron vlerë negative vetëm në tre qarqe (Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë). Vlera më e ulët është regjistruar në qarkun e Gjirokastrës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 56 numrin e lindjeve.

Për publikim 26/12/2017

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T3 - 2017



Lindjet

Numri më i ulët i lindjeve regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 112 lindje, me një rënie prej 42,3 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 2.271 lindje, të cilat shënojnë rënie me 18,5 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016.

Të gjitha qarqet e vendit pësuan rënie të numrit të lindjeve në tremujorin e tretë 2017, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Rënien më të madhe të numrit të lindjeve, gjatë kësaj periudhe, e paraqet qarku i Gjirokastrës me 42,3 % dhe qarku i Vlorës me 32,6 %.

Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve

Qarqet	III - 16	IV-16	I-17	II - 17	III - 17
Shqipëria	9.086	8.119	6.880	6.234	7.203
1 Berat	377	380	294	291	277
2 Dibër	525	431	369	389	381
3 Durrës	951	833	709	634	786
4 Elbasan	903	871	716	563	764
5 Fier	899	851	711	582	655
6 Gjirokastrë	194	168	138	83	112
7 Korçë	575	481	429	423	451
8 Kukës	301	262	237	226	257
9 Lezhë	461	407	327	316	348
10 Shkodër	590	535	447	437	543
11 Tiranë	2.787	2.459	2.087	2.013	2.271
12 Vlorë	488	414	392	253	329
*Të panjohur	35	27	24	24	29

*Kategoria **'Të panjohur'** nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.

Vdekjet

Numri më i madh i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.203 vdekje, me një rritje prej 7,8 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016. Numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 118 vdekje, me një rritje prej 20,4 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2016.

Rënia më e madhe e numrit të vdekjeve në krahasim me tremujorin e tretë 2016, është regjistruar në qarkun e Gjirokastrës me 9,2 %. Në tremujorin e tretë 2017, gjithashtu, me rënie të numrit të vdekjeve paraqitet qarku i Vlorës me 4,5 %, qarku i Lezhës me 4,3 %, qarku i Durrësit me 3,7 % dhe qarku i Korçës me 2,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016.

Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve

	Qarqet	III - 16	IV-16	I-17	II - 17	III - 17
	Shqipëria	4,680	5,782	6,031	4,671	4,853
1	Berat	241	320	338	251	261
2	Dibër	210	264	263	190	215
3	Durrës	428	522	552	418	412
4	Elbasan	442	524	579	496	443
5	Fier	497	652	677	525	597
6	Gjirokastrë	185	207	217	193	168
7	Korçë	486	559	589	469	473
8	Kukës	98	141	147	121	118
9	Lezhë	211	255	265	205	202
10	Shkodër	401	482	522	360	411
11	Tiranë	1,116	1,438	1,448	1,077	1,203
12	Vlorë	357	412	429	363	341
	<i>*Të panjohur</i>	8	6	5	3	9

*Kategoria **"Të panjohur"** nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.

Shënime metodologjike

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen / rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

Burimi i të dhënave: Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.